



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 35/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.01.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ”Tish Daia” me rrugën ”Robert Shvarc”, me nr. REF-28749-10-04-2017, me fond limit 83.282.451,85 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k.

Rruga “Ismail Qemali”, Pll.34/1, Ap.22, Tiranë

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k.

Rruga “Bulevardi Skenderbeg”, pas kinema Millenium, Shkodër

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Tiranë

Sheshi Skënderbej, Nd.2, Kodi Postar 1001, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k., nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k. ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

III.1. Në datën 05.10.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ”Tish Daia” me rrugën ”Robert Shvarc”, me nr. REF-28749-

10-04-2017, me fond limit 83.282.451,85 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

III.2. Në datën 30.10.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “Albavia” sh.p.k. 53.264.896 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k. 60.613.672 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k. 64.099.108 lekë, skualifikuar
4. “Euroteorema Peqin” sh.p.k. 65.000.000 lekë, skualifikuar
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Neal-86” sh.p.k. 67.768.881 lekë, skualifikuar
6. “Ergi” sh.p.k. 69.630.741 lekë, skualifikuar
7. “Company Riviera 2008” shpk 74.095.676,64 lekë, skualifikuar
8. “G.P.G Company” sh.p.k. 74.775.005 lekë, skualifikuar
9. “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. 74.952.388.18 lekë, skualifikuar
10. “Liqeni VII” sh.p.k. 75.583.416 lekë, skualifikuar
11. “Igor Elektrik” sh.p.k. 76.000.906,73 lekë, kualifikuar
12. “Curri” sh.p.k. 77.231.124 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 20.11.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tyre në këtë procedurë prokurimi.

II.3.1. Referuar parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 20.11.2017 ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij.

II.3.2. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë autoritetit kontraktor, ka marrë në dorëzim ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në datë 23.11.2017 dhe në datën 01.12.2017, me anë të shkresës nr.42920/2 Prot., i ka kthyer përgjigje duke e refuzuar ankesën.

II.3.3. Në datën 13.12.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, ky i fundit deklaroi “[...]...më datë 04.12.2017 “Bia Construction” sh.p.k. është vënë në dijeni për përgjigjen e KVO-së, Bahskia Tiranë në lidhje me ankimimin e bërë nga ana jonë....[...].”

II.4. Në datën 20.11.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nuk plotëson pikën 4 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik “Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) personave, për periudhën Shtator 2016 - Shtator 2017 të vërtetuar me; Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Shtator 2016 - Shtator 2017” pasi në vërtetimin për numrin e punonjësve për vitin 2016 e lëshuar nga Administrata Tatimore nuk specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Shtator 2016- Dhjetor 2016, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4.*

- *Bashkimi i operatorëve ekonomik “Nika” sh.p.k. & “SMO Union” sh.p.k. nuk plotësojnë pikën 7 të Dokumentave Standarte të Tenderit, të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve...2 (dy) punonjës pllakashtrues” pasi nuk përmbushin numrin e kërkuar për specialistet pllakashtrues. Pllakashtruesi i paraqitur nga operatori ekonomik “SMO Union” sh.p.k. nuk ka kontrate pune, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.*

- *Operatori ekonomik “SMO Union” sh.p.k. nuk plotëson pikën 4 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik “Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) personave, për periudhën Shtator 2016 - Shtator 2017 të vërtetuar me; List pagesat e punonjësve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shtator 2016 - Shtator 2017, shoqëruar me formularët e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” pasi nuk ka paraqitur formularin e deklaramit te pagesave per muajin prill 2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4.*

- *Operatori ekonomik “SMO Union” sh.p.k. nuk plotëson pikën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm” pasi operatori ekonomik ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me klinikën mjekësore “ZAMA”, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit me pikën 6, pasi nuk janë pjesë e stafit të shoqërisë dhe nuk figurojnë në listëpagesa.*

II.4.1. Referuar parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k., ky i fundit pretendon se në datën 24.11.2017 ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakte që ekzistojnë. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko-ligjor. Së pari, në lidhje me pretendimin se nuk kemi paraqitur vërtetimin përkatës për punëtorët për

periudhën janar 2016 – shtator 2017, sqarojmë se ne kemi paraqitur vërtetim standart që lëshojnë institucionet zyrtare të autorizuar, në rastin konkret të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe Drejtorisë së Tatimpaguesve të Medhenj Tiranë. Këto vërtetime provojnë pagesën e kontributeve të punëtorëve që nga viti 2014 deri në muajin shtator 2017. Për periudhën 2016 ka vërtetim mesatar punëtorësh ndërsa për periudhën 2017 ka vërtetime të specifikuar për cdo muaj pasi kështu është edhe praktika e ndjekur nga institucionet që lëshojnë këto vërtetime. Por në cdo rast janë të ngarkuara edhe listëpagesat përkatëse që provojnë numrin e punëtorëve të cdo muaji dhe me një përllogaritje krejt të thjeshtë gjendet edhe numri mesatar i periudhës janar 2016 – shtator 2017, që duhet thënë është se është shumë më i lartë se ai i kërkuar nga ana juaj. Por sic e cituam edhe më lart, ka një tendencë për të skualifikuar operatorin tonë ekonomik, për të eliminuar konkurrencën dhe jo për të vlerësuar të drejtë. Së dyti, në lidhje me pretendimin se mungon FDP e muajit prill 2017 për SMO Union sqarojmë se ky përbën thjesht një devijim të vogël, pasi sic provohet fakti që janë bërë pagesat e sigurimeve shoqërore për këtë muaj verifikohet nga vërtetimi përkatës për sigurimet shoqërore që ka paraqitur ky subjekt. Ndërsa deklarimi në kohë ligjore brenda afatit të caktuar konfirmohet nga listëpagesa përkatëse e muajit prill 2017. Së treti, marrëdhënia e punës ndërmjet pllakashtruesit të SMO union dhe këtij subjekti provohet nëpërmjet deklarimit të tij në listëpagesa, ku figuron me ditë pune, me profesion dhe me pagë përkatëse. Fakti që punonjësi Besnik Paskalaj është pllakashtrues provohet nëpërmjet dëshmisë përkatëse që ky disponon të lëshuar nga IQT.

Së katërti, shoqëria Nika ka dhe një tjetër pllakashtrues i cili figuron i punësuar dhe me kontratë dhe dëshmi përkatëse të lëshuar edhe ky nga IQT. Së pesti, fakti që kompania SMO Union provohet që ka mjek është e konfirmuar nga kontrata e shërbimit që kjo kompani ka me mjekun Ylber Zama dhe me dokumentacionin e duhur provues dhe tekniko ligjor që është dorëzuar për këtë mjek. Sqarojmë se me këtë vendimarrje të kundraligjshme dhe të padrejtë i shkaktohet një dëm relativisht I madh buxhetit të institucionit tuaj dhe taksave të shtetasve shqiptarë. Sa në sipër kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fitues shoqëria Nika sh.p.k.

II.4.2. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë autoritetit kontraktor, ka marrë në dorëzim ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në datë 30.11.2017 dhe në datën 06.12.2017, me anë të shkresës nr.43286/2 Prot., i ka kthyer përgjigje duke e refuzuar ankesën me argumentimin si më poshtë:

[...]

1.Për sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me vërtetimin e punonjësve, ju bëjme me dije se: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit për Prokurimin Publik, Neni 44 dhe Neni 46, pika 1 germa b, në mbështetje të VKM 914/2014, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngajshëm dhe i shërben autoritetit kontraktor për tu njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. KSHA, pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Nika” sh.p.k. në sistemin elektronik të

vënë në dispozicion nga APP, konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e numrit të punonjësve për secilin muaj për periudhën e kërkuar, të kërkuar sipas pikës 4, të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit. Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

2. Për sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me mosparaqitjen e formularit të deklarimit të pagesave për muajin prill 2017, ju bëjmë me dije se: KSHA pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “S.M.O Union” konstaton që mungon formulari i deklarimit të pagesave për muajin prill 2017. Mungesa fizike e dokumentacionit të sipërcituar, pohohet dhe nga vet ankimuesi në Formularin e Ankesës, duke e konsideruar devijim të vogël.[...] Nisur nga sa më lart, KSHA gjykon se cdo lloj dokumenti i kërkuar nga autoriteti kontraktor për të vërtetuar kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “S.M.O Union” konstaton që mungon formulari i deklarimit të pagesave për muajin prill 2017. Mungesa fizike e dokumentacionit të sipërcituar pohohet edhe nga vetë ankimuesi në formularin e ankesës, duke e konsideruar devijim të vogël.

3. Për sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me mosparaqitjen e Kontratës së Punës së punonjësit pllakashtrues, ju bëjmë me dije se: KSHA pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “S.M.O Union” sh.p.k. në sistemin elektronik të vënë në dispozicion nga APP, konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratën e punës për punonjësën pllakashtrues të kërkuar sipas pikës 7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik të Dokumentave të Tenderit.

II.4.3. Në datën 15.12.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 45737/1 prot., datë 22.12.2017, protokolluar me tonën në datën 26.12.2017, dhe shkresës nr. 45737/1 prot., datë 22.11.2017 (të ridërguar pranë KPP), protokolluar me tonën në datën 29.12.2017, me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij

ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të ankesës të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II.1.1 Në datën 05.10.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ”Tish Daia” me rrugën ”Robert Shvarc”*”, me nr. REF-28749-10-04-2017, me fond limit 83.282.451,85 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

III.1.2. Në datën 30.10.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.3. Në datën 20.11.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.4. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 20.11.2017, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.5. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.42920/2 Prot., datë 01.12.2017, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, ka marrë në dorëzim ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në datë 23.11.2017. Gjithashtu konstatohet se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.1.6. Në datën 13.12.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, ky i fundit deklaron “*[...]...më datë 04.12.2017 “Bia Construction” sh.p.k. është vënë në dijeni për përgjigjen e KVO-së, Bahskia Tiranë në lidhje me ankimitin e bërë nga ana jonë...[...]*”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “*Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” “*Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*” “*Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës*”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “*Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të*

përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, pretendohet se ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k. është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 20.11.2017. Ndërkohë, në shkresën nr.42920/2 Prot., datë 01.12.2017, trajtim i ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, ka marrë në dorëzim ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në datë 23.11.2017. Gjithashtu konstatohet se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit. Referuar ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Mos respektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimues, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 të LPP-së. Sa më sipër, K.P.P konstaton se ankimi i dorëzuar pranë KPP nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues më datë 13.12.2017 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita kur operatori ekonomik ankimues duhet të ishte njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës nga ky i fundit dhe përfundon ditën e dhjetë.

III.1.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k. pranë K.P.P. nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një

rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.10. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Sa më sipër pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

III.2. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit: “*se nuk kemi paraqitur vërtetimin përkatës për punëtorët për periudhën janar 2016 – shtator 2017, sqarojmë se ne kemi paraqitur vërtetim standart që lëshojnë institucionet zyrtare të autorizuar, në rastin konkret të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe Drejtorisë së Tatimpaguesve të Medhenj Tiranë. Këto vërtetime provojnë pagesën e kontributeve të punëtorëve që nga viti 2014 deri në muajin shtator 2017. Për periudhën 2016 ka vërtetim mesatar punëtorësh ndërsa për periudhën 2017 ka vërtetime të specifikuar për cdo muaj pasi kështu është edhe praktika e ndjekur nga institucionet që lëshojnë këto vërtetime.*” dhe pretendimit tjetër se “*mungon FDP e muajit prill 2017 për SMO Union sqarojmë se ky përbën thjesht një devijim të vogël, pasi sic provohet fakti që janë bërë pagesat e sigurimeve shoqërore për këtë muaj verifikohet nga vërtetimi përkatës për sigurimet shoqërore që ka paraqitur ky subject*”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, *Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 4, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) personave, për periudhën Shtator 2016 - Shtator 2017 të vërtetuar me;*

- *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Shtator 2016 - Shtator 2017.*
- *Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2016 - Shtator 2017, shoqëruar me formularët e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

III.2.2. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se, ky i fundit, në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

Shoqëria “Nika” sh.p.k.

- *Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2016, shoqëruar me formularët e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.*

- *Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Janar 2017 – Shtator 2017, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.*
- *Vërtetim Nr. 4461 prot., datë 28.04.2017, ku vërtetohet numri mesatar punonjësish për vitin 2014, 2015, 2016 dhe periudhën janar – mars 2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.*
- *Vërtetim Nr. 18243 prot., datë 25.10.2017, “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore” për numrin e kontribuesve për secilin muaj për periudhën Janar – Shtator 2017, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve Tiranë.*

Shoqëria “SMO Union” sh.p.k.

- *Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2016.*
- *Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Janar 2017 – Shtator 2017, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Mungon formulari i deklarimit të pagesave për muajin Prill)*
- *Vërtetim Nr. 10261 prot., datë 20.10.2017, ku vërtetohet numri mesatar punonjësish për vitin 2014, 2015, 2016 dhe periudhën janar – mars 2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.*
- *Vërtetim Nr. T00007707 prot., datë 25.10.2017, “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore” për numrin e kontribuesve për secilin muaj për periudhën Janar – Shtator 2017, Janar – Dhjetor 2016 dhe Nëntor – Dhjetor 2015, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.*

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Akt Marrëveshje “Për bashkimin e përkohshëm të shoqërive”, “Nika” sh.p.k. dhe shoqërisë “S.M.O. Union” sh.p.k., nga ku shoqëria “Nika” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 24.7% të punimeve dhe shoqëria “S.M.O. Union” sh.p.k. merr përsipër 75.3% të punimeve. Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Nika” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.2.4. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.2.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.2.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.7. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.2.8. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.2.9. Referuar rastit konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë, nuk ka përmbushur kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor. Konkretisht shoqëria “Nika” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur listëpagesat, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave të kontributeve shoqërore për periudhën e kërkuar. Gjithashtu ka paraqitur Vërtetim Nr. 18243 prot., datë 25.10.2017, “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore” për numrin e kontribuesve për secilin muaj për periudhën Janar – Shtator 2017, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve Tiranë, por për periudhën Shtator – Dhjetor 2016 nuk ka dorëzuar dokumentacionin e duhur me të cilin të vërtetojë numrin e punonjësve për secilin muaj për këtë periudhë, duke mos përmbushur kështu kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor.

Për sa i përket, operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë që ka paraqitur ofertë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kjo shoqëri, konstatohet se nuk ka paraqitur formularin e deklaramit të pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për muajin Prill 2016, në kundërshtim me kriterin e vendosur se “Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2016 - Shtator 2017, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”, fakt ky i pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur.

Akoma më tej, KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me dokumentat e tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të*

jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.2.10. Sa më sipër operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mungesa qoftë edhe i një kriterit të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve...2 (dy) punonjës pllakashtrues” pasi nuk permbushin numrin e kerkuar per specialistet pllakashtrues. Pllakashtruesi I paraqitur nga operatori ekonomik “SMO Union” sh.p.k. nuk ka kontrate pune, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 7, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës elektrikist
- 1 (një) punonjës hidraulik
- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 1 (një) punonjës saldator

- 2 (dy) punonjës pllakashtrues

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

III.3.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në lidhje me këtë arsye skualifikimi pretendon se: *“Marrëdhënia e punës ndërmjet pllakashtruesit të SMO Union dhe këtij subjekti provohet nëpërmjet deklaramit të tij në listëpagesa, ku figuron me ditë pune, me profesion dhe me pagë përkatëse. Fakti që punonjësi Besnik Paskalaj është pllakashtrues provohet nëpërmjet dëshmisë përkatëse që ky disponon të lëshuar nga IQT. Së katërti, shoqëria Nika ka dhe një tjetër pllakashtrues i cili figuron i punësuar dhe me kontratë dhe dëshmi përkatëse të lëshuar edhe ky nga IQT.”*

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Akt Marrëveshje “Për bashkimin e përkohshëm të shoqërive”, “Nika” sh.p.k. dhe shoqërisë “S.M.O. Union” sh.p.k., nga ku shoqëria “Nika” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 24.7% të punimeve dhe shoqëria “S.M.O. Union” sh.p.k. merr përsipër 75.3% të punimeve. Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Nika” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.3.4. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.3.5. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se, ky i fundit, në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

Shoqëria “Nika” sh.p.k.

- Kontratë individuale pune ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe punëmarrësit “Avdyl Turbetari” me profesion pllakashtrues. Puna që do të kryejë punëmarrësi Pllakashtrues i firmës.
- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, Nr.007909, për Z. Avdi Turbetari, me profesion Pllakashtrues.

Shoqëria “SMO Union” sh.p.k.

- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, Nr.000597, për Z. Besnik Paskalaj, me profesion Murator – Pllakashtrues.

III.3.6. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.3.7. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.8. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

Në rastin konkret referuar përqindjes që zotëron secili nga anëtarët e bashkimit si dhe punëve të marra përsipër nga secili prej tyre, duhet që të përmbushin kriterin e mësipërm duke paraqitur dy pllakashtrues. Në raport me këtë përqindje, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur kontratë pune me pllakashtruesin “Z. A.T”; dëshminë e kualifikimi të sigurimit teknik; listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit. Ndërkohë që operatori ekonomik “SMO Union” sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ka paraqitur dëshminë e kualifikimi të sigurimit teknik për “Z. B.P” me profesion pllakashtrues dhe listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit (mungon kontrata e punës midis këtij të fundit dhe shoqërisë “SMO Union” sh.p.k.). Pra, nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është paraqitur dokumenti kontratë pune, kërkesë kjo e përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim nga autoriteti kontraktor dhe e detyrueshme për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

III.3.9. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Mungesa qoftë edhe i një kriterit të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm.

III.3.10. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me dokumentat e tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që tre nga pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike e juridike pas arsytimit të Komisionit të Prokurimit Publik mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BIA Construction” sh.p.k. & “S.M.O Vataksi” sh.p.k., për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me objekt *“Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ”Tish Daia” me rrugën ”Robert Shvarc”*, me nr. REF-28749-10-04-2017, me fond limit 83.282.451,85 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “S.M.O Union” sh.p.k., për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1831 Protokolli

Datë 13.12.2017

Nr. 1841 Protokolli

Datë 15.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar

Evis Shurdha

